



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Ligjit mbi tokën ndërtimore ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 14/80 dhe 42/86), nenit 46 të Ligjit për planifikimin dhe rregullimin e hapsirës ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 2/89), nenit 3 të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000, nenit 7 të Rregullorës për Dhënien e Tokës Ndërtimore në shfrytëzim të përkohëshëm për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohëshme nr. 01.-01.-2 të datës 03.01.2002 dhe nenit 19 të Statutit dhe Rregullave të Procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me 27.02.2003, mori

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT DHE DHËNIEN E TOKËS NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHËSHËM PTK-së PËR VENDOSJEN E OBJEKTIT –KONTEJNERIT ME KARAKTER TË PËRKOHËSHËM NË FSHATIN MAT

Neni 1

MIRATOHET Vendimi mbi caktimin e lokacionit për vendosjen e objektit të përkohëshëm-kontejnerit në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 484 Komuna Kadastrale Mati, me sipërfaqe prej 1.0 ari, pronë e Komunës,

Neni 2

Lokacioni nga neni 1. i këtij Vendimi, i jepet në shfrytëzim të përkohëshëm PTK-së në kohëzgjatje prej 1 viti me mundësinë e vazhdimit të kësaj të drejte pas kalimit të afatit të caktuar.

Vazhdimi i afatit të caktuar me alinenë 1 të këtij neni, për shfrytëzimin e tokës ndërtimore nga neni 1 i këtij vendimi, bëhet me kontratë të veçantë në mes Komunës dhe PTK-së..

Komuna ruan të drejtën e pronësisë në tokën nga neni 1. i këtij Vendimi.

Për shfrytëzimin e tokës sipas këtij Vendimi, PTK-ja paguan taksën përkatëse, konform me rregullativën ligjore në fuqi.

Neni 3

Kushtet urbanistiko-teknike dhe lejimin e vendosjes së objektit-kontejnerit i cakton Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, i Komunës së Prishtinës është përgjegjës për kryerjen e veprimeve procedurale nga përgjegjësia e tij për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe pjesa grafike e situacionit të lokacionit nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 253-262 DT. 04.03.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri

ARSYETIM
I VENDIMIT MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT DHE DHËNIEN E TOKËS
NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHËSHËM PTK-së PËR VENDOSJEN E
OBJEKTIT –KONTEJNERIT ME KARAKTER TË PËRKOHËSHËM NË
FSHATIN MATI

PTK-ja me kërkesën 05 nr. 353-994 të datës 14.10.2002 i është drejtuar Drejtoratit të Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë për lejimin e vendosjes së një kontejneri me karakter të përkohëshëm në fshatin Mati Komuna e Prishtinës, i cili do të shërbente për plotësimin e nevojave si objekt i postës për banorët e këtij fshati.

Ky Drejtorat, konform me rregullativën ligjore në fuqi nuk ka mundë të vendos meritore lidhur me këtë kërkesë sepse, kërkuuesi nuk e ka prezentuar provën mbi të drejtën e shfrytëzimit të tokës në të cilën ka kërkuar vendosjen e objektit-kontejnerit, kështu që kjo kërkesë me vendimin e këtij Drejtorati 05 nr. 353-994 të datës 22.11.2002, është refuzuar.

PTK-ja ka inicuar procedurën e dhënies së tokës në shfrytëzim të Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe organet ekzekutive të tij. Duke vendosur sipas kësaj iniciative është ndërë e domosdoshme që Kuvendi i Komunës së Prishtinës me Vendim të veçantë të lejoj shfrytëzimin e përkohëshëm të tokës në të cilën është kërkuar vendosja e këtij objekti-kontejneri.

Ky Drejtorat duke kryer veprime procedurale nga përgjegjësia e vetë ka dalë në vendëshiqim me ç`rast ka konstatuar se toka ku kërkohet vendosja e këtij objekti është e evidentuar si pjesë e ngastrës kadastrale 484 KK Mati dhe e njehta është në pronësinë e Komunës, me ç`rast ka pregaditë prpozimvendimin mbi caktimin e lokacionit dhe dhënien e tokës në shfrytëzim të përkohëshëm kërkuësit për vendosjen e objektit të kërkuar, duke llogaritur se vendosja e një objekti të tillë është e nevojshme për banorët e atij fshati dhe si i tillë është i interesit të përgjithëshëm shoqëror.

Me rregullativën ligjore në fuqi dhënia e tokës në shfrytëzim sipas procedurës së propozuar përkatësiht pa konkurs publik është e lejuar për rastet kur si shfrytëzues dhe investitor paraqiten organizatat me interes tëpërgjithëshëm shoqëror.

Prandaj në mënyrë që të lejohet vendosja e objektit të kërkuar është e domosdoshme që Kuvendi i Komunës paraprakisht t`i jap në shfrytëzim të përkohëshëm duke miratuar prpozimvendimin e prezentuar.

DREJTORATI I PLANIFIKIMIT, URBANIZMIT DHE NDËRTIMTARISË
I KOMUNËS SË PRISHTINËS.